



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 26.11.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 22.11.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NSH EKO-DDD" për aktivitetin: "Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i Institucioneve Arsimore" me numër të prokurimit: 616 -19-1655-221 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "NSH EKO DDD" e datës 22.11.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit 'Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i Institucioneve Arsimore' me numër të prokurimit: 616 -19-1655-221' kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 19.11.2019*, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.

1. Vertetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 19.11.2019 ;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "NSH EKO-DDD" me datë 22.11.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i Institucioneve Arsimore" me numër të prokurimit: 616 -19-1655-221. Autoriteti Kontraktues, me datë 26.11.2019 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet e parashtruesit te kerkeses lidhur me te gjitha mangesite e tenderit te kandidatit te propozuar per dhenje te kontrates mund te jene te bazuara per ne si Autoritet Kontraktues ,por jo edhe per OSHP-ne qe eshte organ per shqyrtim te ankesave.Ua perkujtojmë se shumicen prej mangesive qe ju i keni cekur ne kerkesen tuaj si mangesi qe e bejne tenderin e te njejtit te pa pergjegjshem i kemi konstatuar ne vleresimet paraprake ,por te gjitha jane refuzuar nga Vendimet e OSHP-se.E verteta eshte se OSHP-ja e ka kthyer aktivitetin ne rivleresim,por i ka pranuar pretendimet e ankuesit dhe i ka konsideruar si te pa

ligjshme rekoamdimet tona qe ju te jeni fitues i kontrates,prandej kete here eshte vendosur sipas rekomandimeve te OSHP-se.

Bazuar ne konstatimet paraprake konstatoj se Autoriteti Kontraktues nuk mund te marre Vendim tjetër perpos atij qe e rekomandon OSHP-ja,pa marre parasysh konstatimet tona te meparme.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit